

RELACION TEKNIK

Sifoni ujites dalja e rezervuarit Shumbat eshte nje projekt qe per nga pikpamja praktike e funksionimit i sherben komunitetit te fshatit Shumbat te Njesise Administrative Sllove ne Bashkine Diber. Ky projekt ben te mundur permisimin e infrastruktures vaditese , rritjen e shpejtesise se levizjes se ujit,eliminimin e humbjeve te ujit , shtimin e sipërfaqes nen uje te ketij fshati.

Meqenese kanali ekzistues eshte ndertuar para 27 vitesh ai eshte demtuar, dhe per shkak edhe te perqindjes se pjerresise qe eshte gati me pak se nje per mije ka ulur ndjeshem rendimentin ne procesin e vaditjes. Ky sifon i projektuar do te rris eficencene nje sipërfaqe mbi 70 ha ne vaditje dhe eliminimin e humbjeve .

Pergjate gjatesise se ketij sifoni do te lihen nje pike shkarkimi (pas 312 m nga pika lidhjes) ,dhe dy puseta komandimi ne te cilat do te kete dy pika lidhje (per degezim tubacioni) te cilat do te sherbejne per futjen nen uje te nje sipërfaqe prej 15 ha te cilat u sherbejne rreth 20 fermere,degezime te cilat do te behen ne vazhdim.

Ky sifon merr uje ne rezervuarin e Shumbatit ,rezervuar i cili nuk eshte ne kapacitetin e tij te plote per shkak te mbushjeve pergjate 70 viteve te funksionimit te tij duke ulur ndjeshem kapacitetin ,dhe duke mos plotesuar nevojat e vaditjes ,çka e ben te nevojshme permisimin e kesaj infrastrukture vaditese . Ky sifon do te lidhet me tubacionin shkarkues te liqenit dhe do te kete nje gjatësi rreth 960 meter,komandimi i te cilit do te behet me saracineske Ø250 ne puseten e hyrjes.

Per ndertimin e tij do te perdoren rakorderi dhe tuba PE d=250 mm. Ne hyrje dhe dalje te sifonit do te behen dy puseta me beton C16/20. Per vendosjen e tubacionit jane planifikuar punime germimi dhe punime per ngjeshjen e dherave. Gjate vendosjes se tubit do te inspektohen ne menyre te kujdesshme qe te jene te standarteve dhe kerkesave te specifikimit.Ne fund te tubacinit do te behet riparimi i kanalit sipas profilit te projektit. ***Venia ne pune e ketij projekti me standarte pervec jetegjatesise se tij ne funksion te vaditjes nuk ka kosto te tjera shtese per mirembajtjen e tij.***

Do te kryhen disa punime dhe ne kanalim Nagjare te ketij fshati duke vendosur tub te brinjzuar ne nje pjese te kanalit e cila eshte e rreshqitshme dhe nuk mund te behet kanal betoni. Punimet do te kryhen ne kuotat ekzistuese te kanalit vadites. Pasi perfundon tubi do te behet kanal me beton C16/20 ne formr

tapezoidale dhe drejtekendeshe .

Ky projekt preventiv eshte hartuar me cmimet e manualit te vitit 2015 dhe kap vleren **9.998.142** me **t.v.sh.**

Meqenese ky fond eshte siguruar nga Bashkia lind nevoja e kerkeses per fonde te tjera shtese per venien ne funksionim te dy degezimeve te ketij projekti.

Projekti eshte hartuar nga Ing. Zenulla Mehmeti i licensuar nga Ministria e Puneve Publike dhe transporteve mbeshtetur ne gjendjen ekzistuese te terrenit per permisimin dhe plotesimin e kerkesave per vaditje.

Pergatiti

Ing.Zenulla Mehmeti